

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
BISCHA ELEKTRO TECHNIK SHPK

NENI 1

Themelimi dhe emri

Sot me date 26.07.2021, nepermjet ketij akti, une i nenshkruari krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **BISCHA ELEKTRO TECHNIK SHPK.**, ne perputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar.

Themeluesi i shoqerise eshte Z. Arbis Prifti shtetas shqiptari lindur me 29.02.1988, ne Fier, mbajtes i pasaportes numer personal I80229069F.

NENI 2

Objekti

Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here. Aktiviteti i Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet me punime elektrike, shtrirje kabulli, prerje muresh, montime te ndryshme dhe te ngjashme me keto.

NENI 3

Selia

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Ismail Qemali Nr. 29/1, Ap 3, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojte filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar.

NENI 4

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

NENI 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100 Lek (njqind Leke). Kapitali eshte i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 Leke.

Kapitali ne para eshte nenshkruar nga Ortaku i vetem zoterues i 100% te kapitalit te Shoqerise. Pergjegjesia e Ortakut te vetem per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.



NENI 6

Administrimi i Shoqerise

Shoqeria administrohet nga Administratori i Vetem i emeruar nga Asambleja e Ortakeve.

Administratori do te veproje dhe do te perfaqesoje Shoqerine ne baze te kompetencave dhe mandatit te emerimit sipas legjislacionit shqiptar dhe Statutit te Shoqerise.

Ortak i Vetem i Shoqerise eshte Z. Arbis Prifti shtetas shqiptari lindur me 29.02.1988, ne Fier, mbajtes i pasaportes numer personal I80229069F.

Administratori i Vetem emerohet per nje periudhe 5 vjeçare dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 7


Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me themelimin e Shoqerise dhe perfundon ne date 31 dhjetor te te njejtit vit.

Ky akt themelimi hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM



ARBIS PRIFTI

NENI 9

VITI USHTRIMOR

Viti ushtrimor i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.

NENI 10

LIKUIDIMI

Likuidimi e Shoqerise si dhe emerimi i likuidatorit(eve) behet ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjeter te zbatueshem.

NENI 11

LIGJI I ZBATUESHEM

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me legjislacionin shqiptar.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

Çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, do te zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 12

NDRYSHIMET

Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet ose shfuqizohet,ose te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Ortakut te Vetem.

Ky Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM



ARBIS PRIFTI